



Nr.11/prot

Data 31/05/2022

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË



VENDIM

Nr. 6, datë 20/05/2022

PËR

**MIRATIMIN E LEJES “PËR PËRDORIM BURIMI UJOR  
SIPËRFAQËSOR PËR AKUAKULTURË (NË RASTIN E UJËRAVE  
TË RJEDHSHËM) NË RASTIN KUR PËRDORIMI ËSHTË PËR >5  
TON/VIT, >5 L/SEK”, SUBJEKTIT “KILIC AQUACULTURE  
ALBANIA” SH.A**

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Drin-Bunë.

V E N D O S I:

1. Miratimin me kusht të lejes “Për përdorim të burimit ujor sipërfaqësor për akuakulturë (në rastin e ujërave të rjedhshëm) në rastin kur përdorimi është për >5 ton/vit, >5 l/sek”, subjektit “Kilic Aquaculture Albania” sh.a, me vendndodhje Bashkia Vau-Dejës, Qarku Shkodër, sipas këtyre koordinatave:

2. Treguesit paraparak janë si më poshtë:

Vendndodhjet e burimeve ujore (KRGJSH), Pompat e ish fabrikës së Pasurimit të Bakrit në Vaun e Dejës.

- X=470400
- Y=4652614
- Z=20 m.m.n.d

Prurja e ujit që jepet për përdorim: 300 l/sek.

Prurja mesatare vjetore: 1190 l/sek.

Pika e shkarkimit (KRGJSH).

- X= 470342
- Y= 4652652
- Z=20 m.m.n.d
- Sasia e ujit që shkarkohet: 300 l/sek

3. Kjo leje jepet me kushtin e lidhjes së kontratës së ushtrimit të aktivitetit me ministrinë përgjegjëse, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fushën e akuakulturës.

4. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I KBU DRIN-BUNË**

**MAJLINDA ANGONI**

